

VENDIM
Nr.646, datë 28.7.2010

**PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE
NË FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 17 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, të shkronjës "ç" të nenit 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve", të ndryshuar dhe paragrafit të tretë të nenit 175 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit në pronësi të poseduesve të objekteve informale, të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore, të zëna, sipas listës dhe planvendosjeve përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi, përkatësisht:

a) në qarkun Tiranë, 5445 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 1 784 513, 40 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e trembëdhjetë presje dyzet) m²;

b) në qarkun Durrës, 518 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 184 510,40 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e dhjetë presje dyzet) m²;

c) në qarkun Shkodër, 7 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 439,90 (katërqind e tridhjetë e nëntë presje nëntëdhjetë) m²;

ç) në qarkun Lezhë, 76 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 31 089,06 (tridhjetë e një mijë e tetëdhjetë e nëntë presje zero gjashtë) m²;

d) në qarkun Berat, 86 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 25 513,35 (njëzet e pesë mijë e pesëqind e trembëdhjetë presje tridhjetë e pesë) m²;

dh) në qarkun Fier, 495 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 138 618,38 (njëqind e tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë presje tridhjetë e tetë) m²;

e) në qarkun Korçë, 2 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 325,69 (treqind e njëzet e pesë presje gjashtëdhjetë e nëntë) m²;

ë) në qarkun Elbasan, 370 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 85 247,50 (tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind e dyzet e shtatë presje pesëdhjetë) m²;

f) në qarkun Gjirokastrë, 15 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 854,40 (dy mijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër presje dyzet) m²;

g) në qarkun Vlorë, 416 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 156 308,50 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tetë presje pesëdhjetë) m²;

gj) në qarkun Kukës, 64 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 28 733,47 (njëzet e tetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre presje dyzet e shtatë) m²;

h) në qarkun Dibër, 22 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 4 409,20 (katër mijë e katërqind e nëntë presje njëzet) m²;

2. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale, nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha